Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**05.10.2023**	**20.10.2023**	**2023/0748**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.09.2023, OE "AGRI BAU SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0748, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Piruner" me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimi për kontratë 09.08.2023

Hapja e Ofertave 01.09.2023

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së 15.09.2023

Kërkesa për Rishqyrtim 19.09.2023

Vendimi ndaj Kërkesës për Rishqyrtim 20.09.2023

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1- Qëllimi LPP-se

Neni 59-Egzaminimi ,Vlersimi,dhe Krahasimi i Tenderve i LPP-se,

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtese i LPP-se,

Rregulloren nr.001/2022 te Prokurimit Publike, Neni 40.12 Ekzaminimi, Krahasimi i Tenderëve,

RRUOPP NEN-i 39.8 ne perputhje me Nenin 69 te LPP-se

Deklaratë detale mbi faktet dhe Argumentet

Me daten 19.09.2023 Agribau SHPK kemi bere kerkese per Rishqyrtim te Vendimi AK-se te dates 15.09.2023 per aktivitetin e prokurimit **Furnizim me Piruner** nr.prokurimi #**214-23-8209-1-2-1** me te cilin vendim **AK ka** eliminuar kompanine OE "AGRIBAU" SHPK me arsyetimin se oferta jone per te dy Lotet (Lot 1, Lot 2 administrativisht e papergjegjshme me qerast eshte anuluar aktiviteti i prokurimit p tender.

Zyra e Prokurimit me rastin e anulimit te Aktivitetit te prokurimit ka derguar Letr Standarde per tenderuesin e Eliminuar per Agribau SHPK me arsyetimin se oferta per te dy Lotet eshte administrativisht e papergjegjshme sepse; ***nuk keni dorezuar katalogun, keni ofruar vetem foto dhe keni shenuar vet te dhena ku nuk deshmo modelin e ofruar dhe nuk e ploteson kriterin kualifikues te DT-se.***

Me rastin e kerkeses tone per Rishqyrtim, pretendimi jone ka qene se; Vendimi i A per eliminim e kompanise tone dhe Anulimin e aktivitetit te Prokurimit eshte ne kundershtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik po ashtu me Rregulloren dhe Udhe Operativ te Prokurimit Publik pikerisht NEN-et;

- ***Neni 1- Qëllimi LPP-se***
- ***Neni 59-Egzaminimi ,Vlersimi,dhe Krahasimi i Tenderve i LPP-se,***
- **Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtese i LPP-se,**
- ***Rregulloren nr.001/2022 te Prokurimit Publike, Neni 40.12 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,***
- **RRUOPP NEN-i 39.8 ne perputhje me Nenin 69 te LPP-se**

Me daten 20.09.2023 AK ka marrur vendim per refuzim te kerkeses per Rishqyrti mos arsyetuar ne menyren e duhur vendimin per refuzim por vetem ka perseritur "**AK nuk ka bere shkelje te ligjit", "nuk keni ofruar asnje specifike teknike**" mos marrur per baze asnje dokumentacion te dorezuar si psh. Deklaraten mbi Specifikimet teknike, Katalogun me specifikime teknike te prezantuar nga ana jo

Arsyetimi i AK-se ne vendimin per refuzim lidhur mos respektim te NEN-it 59 es kontradiktor ne vete ku thuhet; ***"kriter kualifikues ka qene Katalog per te gjithe me te cilin eshte e mundur vleresimi i specifikave sipas Aneksit 1 te DT-se***.

Ndersa ne anen tjeter thuhet se; *ju nuk keni ofruar katalog te* ***Prodhuesit,*** me kete ne arsyetim vet e pohon se nuk ka qen kriter katalogu nga prodhuesi apo te vulos prodhuesi apo apo ndonje format i veqant tek specifikimet teknike ndersa ne arsy qe nuk keni dorezuar katalogun e prodhuesit.

Ky arsyetim bjen ne kundershtim edhe me *Rregulloren nr.001/2022 te Prokurimit P*
Neni 40.12 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ku thuhet se; ***Tenderu***
nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të
kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen e ten

Refuzimi i dokumentacionit dhe mos pranimi si dokumentacion per shqyrtim nga

AK-se i "Deklarates per specifikime teknike dhe Katalogut me Specifika tekn
dorezuar te nga ana jone eshte bere qellimisht nga AK vetem qe ti iket NEN-it 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, **si dhe NEN-it 39.8 te RRUOPP-se ku thuh**
RRUOPP 39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të
prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument t
shkruar me anë të sistemit elektronik

Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	*Mund të kërkohen informata sqaruese*	*69*

Pretendimi jone ne kerkesen per Rishqyrtim ka qene se ne kemi dorezuar oferten t
administrativisht te pergjegjshme ku kemi dorezuar Deklaraten per specifikime tek
Katalogun me Specifika teknike dhe AK ne rast te nevojes per sqarime apo plotesi
dokumenteve ekzistuese te respektoj NEN-et e lartcekura dhe te na ipet mundesia e
sqarimit, plotesimit te dokumentave ne fjale.

AK nuk ka kerkuar katalog nga Prodhuesi dhe se katalogu standard i prodhuesit i p
disa nga detajet te cilat i ka kerkuar AK tek specifikimet teknike si psh; Vitin e Pro
ose Garancionin 12 muaj dhe per kete shkak ne kemi dorezuar katalogun ne forma
AK te kete me te leht vleresimin e ofertes dhe me rastin qe AK do te kerkonte sqar
baze te NEN-it 72 te LPP-se dhe NEN-it 39.8 te RRUOPP-se ne do ti ofronim desl
shtese nga prodhuesi te mjaftueshme se pajisjet e ofruara jan ne perputhje me spec
teknike sipas aneksit 1 te DT-se.

Te nderuar; Ne si OE jemi te autorizuar nga prodhuesi ku edhe posedojme Autorizi
nga prodhuesi HELI per pajisjet te ketij brendi, ku qdo informate apo sqarim qe do
kerkohej do te ishte shume i leht per vertetimin e specifikimeve apo lehtesimin per
vleresim te ofertes tone.
Ne katalogun e ofruar ne kemi dhene Modelin e pajisjeve, Prodhuesin e pajisjeve,
Specifikimet e pajisjeve, Fotot e pajisjeve sipas kerkeses se AK tek Aneksit 1 te DT
dhe kemi bashkangjitur Deklaraten per Specifikime Teknike ku jemi zotuar se; te g
mallrat e ofruara në listën e përshkrimit të çmimeve janë në përputhje me specifika
teknike sipas Aneksi 1. te DT-se.
Ne perveq deshmive te ofruara jemi ne dijeni se pajisjet e ofruara ne momentin e li
do ti nenshtrohen nje komisioni i cili do te konstatoj se pajisjet jan ne perputhje me
specifikimet sipas aneksit 1 te DT-se, dhe pasojat qe lindin nese pajisjet nuk do te
pranohen nga ana e komisionit.
Pas gjitha ketyre fakteve te ofruara shpresojm dhe besojm se Organi Shqyrtues i Prokurimit do ta shqyrtoj ankesen tone dhe do ta aprovoj si te bazuar duke marre

Vendim

APROVOHET *si e bazuar ankesa e OE "Agribau" SHPK kunder Vendimit te AK-se date 20.09.2023 per Refuzim te kerkeses per Rishqyrtim*
ANULOHET *njoftimi mbi Vendimin e AK-se dates 15.09.2023 dhe lenda te kthehet ne* ***Ri-vleresim*** *me qellim te marrjes se nje vendimi ne perputhje me Ligjin mbi Prokurimin Publi*

Me respekt _____
Agribau shpk SH.P.K. ***date 30.09.2023***

KRITERET PËR VLERËSIM

Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Çertifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet te regjistroj përfaqësinë ne Kosovë para nënshkrimit te kontratës)	**Dëshmia 1- Kopja e certifikatës të numrit unik**
Kërkesa 2. Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor)	**Dëshmia 2. Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor)**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Policia e Kosovës Anulon te gjitha pjesët për aktivitetin e prokurimit përgjegjshme.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues kualifikohet si pale me interes sipas Nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **AGRI BAU SH.P.K.**

Pretendimin ankimor 1

Përmbledhje e pretendimit ankimor 1

OE ankues pretendon se vendimi i AK-së për eliminimin e kompanisë tonë është në kundërshtim me Nenin 1, 59 dhe 72 të LPP-së. Ne jemi eliminuar me arsyetimin se " nuk keni dorëzuar katalogun, keni ofruar vetem foto dhe keni shenuar vet te dhena ku nuk dëshmon modelin e ofruar dhe nuk e plotëson kriterin kualifikues të DT-së. AK ka kërkuar katalog me të dhëna të mjaftueshme për vlerësim sipas aneksit 1 të DT-së, që do të thotë se katalogu duhet ti ketë të dhënat të cilat ju i keni kërkuar te aneksi 1 dhe për këtë arsye ne kemi dërguar katalogun i cili përmban të gjitha të dhënat e kërkuara për vlerësim si dhe modelin e pajisjes, viti i prodhimit, garancionin për pajisjen, foto të pajisjes dhe nuk qëndron fakti se ne nuk kemi dhënë-dëshmuar modelin e pajisjes me të cilin ofertojmë. Ne nuk e dijm se qfar keni nënkuptuar me fjalën katalog, si dhe cfarë duhet të posedoj tjetër një katalog i pajisjes apo si e keni klasifikuar fjalën katalog.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 1

Eksperti Shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "***Katalog për të gjithë artikujt me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit*".**

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "***Katalogu për të gjithë artikujt me detaje të mjaftueshme për vlerësim sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit*".**

Pas analizimit të dokumentacioneve të ofruara në E prokurim, eksperti shqyrtues, sqaron se për plotësimin e kërkesës së DT-së së lartcekur, OE ankues ka ofruar dëshmin me ëmrtim Katalogu me specifike teknike Lot 1; Lot 2;, dokumenti përmban fotografin e produktit dhe përshkrimine produktit.

AK në përgjigjjen për rishqyrtim ka theksuar se:citat: "*Në ofertën tuaj ju nuk keni dorëzuar asnjë katalog, OE ka dorëzuar një dokument të prezantuar si katalog të përgatitur me foto të bashkangjitura dhe vetëm keni përshkruar specifikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit dhe nuk keni ofruar* ***katalogun e prodhuesit****....*" mbyll citatin.

Eksperti Shqyrtues vlerson se AK nuk ka respektuar në tërsi paragrafet e nenit 59 të LPP-së, për faktin se kërkesë e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që katalogu të jetë nga prodhuesi, dhe dokumeti i ofruar nga OE ankues i cili i përmban të dhënat e kërkuara në aneksin 1 të DT-së, plotëson kërkesën e DT për faktin se AK kërkesën e ka përgjithsuar, dhe nuk e ka specifikuar që kërkesa të jetë nga prodhuesi, dhe implementimi i një kërkesë duke specifikuar prodhuesin në rastin konkret bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-së i cili thotë:citat "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*mbyll citatin.

Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues për Lot 1, Lot 2 të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AGRI BAU SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica